

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Regjionale Gjilan (AKP), të cilën me autorizim e përfaqëson Xhelal Salihu, zyrtar ligjor, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës të cilën me autorizim e përfaqëson Sevdai Morina, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, përkitazi me revizionin e paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4063/2014 datë 17.9.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 5.12.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditëses paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4063/2014 datë 17.9.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4063/2014 datë 17.9.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, C.nr.166/2012 datë 19.6.2014, me të cilën është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Agjencia Kosovare e Privatizimit Zyra Regjionale Gjilan (AKP), që të vërtetohet se N.Sh. “K. B. “A.” në ..., ndaj Komunës së Kamenicës është pronare e ngastrave kadastrale: P-..., në sipërfaqe prej 1075 m²; P-..., në sipërfaqe prej 1501 m²; P-..., në sipërfaqe prej 148 m²; P-..., në sipërfaqe prej 12306 m²; P-..., në sipërfaqe prej 8827 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3182 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3182 m²; P-..., në sipërfaqe prej 4216 m²; P-..., në sipërfaqe prej 791 m²; P-..., në sipërfaqe prej 6683 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3942 m²; P-

..., në sipërfaqe prej 490 m²; P-..., në sipërfaqe prej 5232 m²; P-..., në sipërfaqe prej 1030 m²; P-..., në sipërfaqe prej 625 m²; P-..., në sipërfaqe prej 1466 m²; P-..., në sipërfaqe prej 4482 m²; P-..., në sipërfaqe prej 285 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3602 m²; P-..., në sipërfaqe prej 260 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3732 m²; P-..., në sipërfaqe prej 270 m²; P-..., në sipërfaqe prej 3937 m²; P-..., në sipërfaqe prej 325 m²; P-..., në sipërfaqe prej 2301 m²; P-..., në sipërfaqe prej 2291 m²; P-..., në sipërfaqe prej 9785 m², të gjitha në vendin e quajtur ..., të evidentuara në certifikatën e pronës UL-..., ZK Kamenicë. Me pjesën II. të dispozitivit është detyruar paditësja AKP-ja, që në emër të taksës për vendim gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 50 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim përmbarimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësja me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditëses të aprovohet në tërësi si e bazuar ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje në revizion me propozim që revizioni i paditëses të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se N.Sh. K. B. "A." në ..., më datë ..., është regjistruar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut si ndërmarrje shoqërore për kultivimin e prodhimeve bujqësore. Në mes palëve nuk ka qenë kontestues fakti se ngastrat kadastrale të shënuara në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të gjitha të evidentuara në certifikatën e pronës UL – ..., z.k. ..., janë të regjistruara në emër të paditurës, të cilat ngastra për një kohë të gjatë kanë qenë në shfrytëzim të N.Sh. K. Bujqësore "A." në ..., ku janë ndërtuar serat prej metali dhe qelqi për mbjelljen dhe prodhimin e perimeve. Sipas vendimit të Kuvendit Komunal nr. ..., datë ..., për

lokacionin ku janë ngastrat kadastrale kontestuese, parashihet ndërtimi i banimit kolektiv me etazhitet P +7K.

Paditësja me padi ka kërkuar që të vërtetohet se është pronare e këtyre ngastrave në bazë të shfrytëzimit - mbajtjes me mirëbesim, konform nenit 28 par. 4 të LTHMPJ.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të nxjerra ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar ngase e njëjta nuk ka arritur të bëjë të besueshme kërkesën e sajë dhe gjykatës nuk i ka prezantuar provë e cila vërteton bazën juridike të shfrytëzimit të ngastrave kontestuese dhe duke aplikuar nenin 29 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Juridiko-Pronësore, me të cilën përcaktohet se e drejta e pronësisë me parashkrimin fitues nuk fitohet në pronën shoqërore, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Ka vlerësuar se mbi gjendjen e vërtetuar faktike drejt është zbatuar e drejta materiale, ku gjykata e shkallës së parë i referohet dispozitave përkatëse ligjore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur është përpiluar padia.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Kjo Gjykatë, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët dhe vlerëson se refuzimi si i pabazuar i kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i ligjshëm.

Thëniet e revizionit të paditëses se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe me shkresat e lëndës, në aktgjykimin e kundërshtuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike mbi të

gjitha faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, duke nxjerrë konkludime të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë. Në revizion përveç që është cituar dispozita ligjore e cekur më lartë nuk është theksuar asnjë pretendim konkret se ku qëndrojnë shkeljet e pretenduara, në cilën pjesë të aktgjykimit apo cilat fakte nuk i kanë arsyetuar gjykatat e instancës më të ulët, e të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar.

Gjithashtu edhe pretendimi se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me shkeljen thelbësore nga neni 182 par. 1 lidhur me nenin 8 të LPK –ës, siç theksohet në revizion, provat e nxjerra nga gjykata nuk janë vënë në relacion krahasues dhe nuk janë analizuar me dozën më të madhe të kritikës dhe analizës, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e saj e ka bazuar në provat e prezantuara nga palët ndërgjyqëse të cilat i ka shqyrtuar konform nenit 8 të LPK –ës, secilën veç e veç dhe në lidhshmëri njëri me tjetrin, ndërsa në bazë të rezultatit të gjithë procedimit ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi. Thëniet në revizion janë të përgjithësuara dhe me asnjë pretendim konkret nuk ka vënë në dyshim ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar dhe nuk është cekur asnjë provë të cilën gjykata nuk e ka shqyrtuar apo analizuar.

Faktin e cekur në revizion se paditësja nuk ka arrit të gjejë aktvendimin e Kuvendit Komunal ose ndonjë akt tjetër komunal, për dhënien e këtyre parcelave në shfrytëzim të përhershëm, mbi bazën e së cilës N.Sh. "A." e ka fituar të drejtën e pronësisë (neni 20i LTHMPJ), për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë, kjo Gjykatë e shqyrtoi por e njëjta nuk ndikojë që kjo gjykatë të vendosë ndryshe, ngase me të drejtë gjykata e shkallës së dytë ka aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë se me parashkrimin fitues, nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore. Me nenin 16 të Ligjit për ndryshimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (Fl.zyrt.e Jug.nr.29/96) është shlyer neni 29 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (LTHMJP), i cili parashikonte se nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasurinë shoqërore me parashkrimin fitues, pas këtij ndryshimi mbi pronën shoqërore mund të fitohet e drejta e pronësisë me parashkrimin fitues. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, norma ligjore bëhet për të rregulluar raportet juridike në të ardhmen, përveç nëse në ligj shprehimisht është cekur se kjo normë ka ndikim prapaveprues, ndërsa me ligjin e përmendur më lart, nuk është parashikuar se kjo normë ka ndikim prapaveprues. Paditësja ka deklaruar se patundshmërinë kontestuese e shfrytëzon nga viti 1976,

ndërsa si ndërmarrje shoqërore K. B. "A." është regjistruar në vitin 1990, mirëpo deri në ndryshimin e ligjit MTHMJP në vitin 1996 të drejtën e pronësisë nuk ka mund ta fitojë me parashkrimin fitues, ndërsa nga viti 1996 e deri në kohën e ushtrimit të padisë më 2012 nuk ka kaluar koha e paraparë dhe nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për fitimin e pronësisë dhe të drejtës së shfrytëzimit të patundshmërinë kontestuese, andaj edhe pretendimin se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, Gjykata Supreme e vlerësoi si të pabazuar.

Pretendimin e revizionit se e paditura e ka humbur të drejtën e pronësisë në kuptim të nenit 46 të LTHMPJ, sepse për 36 vite nuk është interesuar fare për këto parcela dhe të njëjtat konsiderohen braktisje e sendit, Gjykata Supreme i refuzojë si të pabazuara nga arsyet të cilat u dhanë më lartë.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 5.12.2018, Rev.nr.401/2018

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku

